



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

ZL.Anr.205-2/2025

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP), i përbërë nga gjyqtarët: Kymete Kicaj - kryesuese, Arsim Hamzaj dhe Skender Çoçaj - anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e kandidatit i pavarur për kryetar të Komunes Kllokot, Arber Emini, e paraqitur kundër subjektit politik Srpska Lista dhe subjektit politik Srpska Narodna Sloga (SNS), për shkak të parregullsive për ditën e zgjedhjeve, në ditën e votimit për Zgjedhjet Lokale, të mbajtura më datë 12 Tetor 2025, në seancën e panelit të mbajtur me 24.10.2025, merr këtë:

V E N D I M

REFUZOHET E PABAZUAR ankesa ZL.Anr.205/2025, të datës 13.10.2025, e paraqitur nga kandidatit i pavarur për kryetar të Komunës së Kllokotit, Arber Emini, e paraqitur kundër subjektit politik Srpska Lista dhe subjektit politik Srpska Narodna Sloga (SNS), për shkak të parregullsive për ditën e zgjedhjeve, në ditën e votimit për Zgjedhjet Lokale, të mbajtura më datë 12 Tetor 2025.

A r s y e t i m

Me datën 13.10.2025, PZAP-i ka pranuar ankesën e kandidatit të pavarur për kryetar të Komunës së Kllokotit, Arber Emini, me të cilën pretendon se me datë 12.10.2025 në Kllokot në Zgjedhjet Lokale në Kllokot, Serbia ka ndërhyrë në sistemin Zgjedhor në Komunen e Kllokotit duke fabrikuar dëshmi mjekësore serbe të strukturave paralele për tu shfrytëzuar votuesit me asistencë të përdorin këtë vërtetim mjekësor. Votuesit shqiptar nuk kanë mundur të realizojnë këtë të drejtë sepse nuk kanë pasur vërtetime mjekësore valide të Republikës së Kosovës, por Lista Serbe dhe SNS kanë organizuar këtë metodë të kundër Rendit Kushtetuese se Republikës së Kosovës me qellim që të ndërhyj dhe të ndikojnë në rezultatin e zgjedhjeve në Kllokot, me këto dokumente jo valide të cilat në asnjë moment nuk ishin të njoftuar komisionerët dhe vëzhguesit e asnjë subjekti politik se nuk duhet ti lejohet votimi me këto dokumente të Republikës së Serbisë të lëshuara në Kosovë. Të gjitha votat me asistencë kanë përdorur dëshmi mjekësore vetëm nga institucionet shëndetësore jo valide në Kosovë dhe në disa raste nga vërtetime të falsifikuara edhe nga ndonjë institucion shëndetësor nga sistemi i RKSK. Tutje ka shtuar se, në shkollën “Sveti Sava” në Kllokot kjo metodë ka ndikuar në rezultatin zgjedhor dhe sipas informacioneve që janë ardhë nga vëzhguesit në këtë shkollë në vendvotimin me numër: 3701-SH.F.M.U Sveti Sava në Kllokot. Vendvotimet: 3701/02 janë shkelur te drejtat themelore te njeriut dhe është shkelur procedura për numërimin e fletëvotimeve te votimit. Në këto dy vendvotime janë konstatuar nga ana e

vëzhguesve të mi se nuk ka filluar procesi i numërimit në kohen e duhur, por në fillim janë hapur dy kutit dhe pastaj kanë filluar numërimin e votave vetëm për Kuvend Komunal dhe me vonë për kryetar të komunës së Klllokotit. Dyshimet tona janë esenciale dhe ndërhyjnë në rezultatin e zgjedhjeve sepse edhe votimi me asistencë me këtë metodë ka ndikuar në këtë vendvotim dhe në të gjitha vendvotimet tjera kanë pasur ndikim dhe efekt që ndikojnë direkt në jetën e çdo qytetari në Klllokot. Kërkoj nga PZAP të marr vendim mbi rinumërimin e të gjitha vendvotimet në Komunën e Klllokotit dhe nëse konstatohen këto veprime të Serbisë apo Listës Serbe dhe SNS në Klllokot, kërkoj nga ana juaj që të anulohen vendvotimet me asistencë me dokumente mjekësore të Serbisë si jovalide në RKS dhe të përsëritet votimi në komunën e Klllokotit për kryetar komune në të gjitha ku konstatohet këto veprime të Serbisë në zgjedhjet në Klllokot, vendvotimet në Klllokot që kërkojmë të përsëritet votimi janë vendvotimi: 3701/02.

Parashtuesi i ankesës lidhur me pretendimet e tij ka bashkangjitur si provë dëshmi e kryerjes së veprimit, përkatësisht dokumentin mjekësor të lëshuar nga Republika e Serbisë.

Në përgjigjen në ankesë subjekti politik Srpska Lista, me datë 14.10.2025, ka deklaruar se kjo ankesë është paradoksale, e pabazuar dhe absolutisht e paarsyeshme nga ana juridike. Para së gjithash, si subjekt legal politik në Kosovë, në nuk kemi kompetenca mbi institucionet shëndetësore, qofshin ato që funksionojnë në sistemin serb apo kosovar. Duke u nisur nga ky fakt, nuk shohim të kuptimtë që ankesa të referohet subjektit tonë politik. Po ashtu, ne as nuk e dimë dhe as nuk mund ta dimë se nga erdhi kjo dëshmi, si dhe pse u lëshua, dhe ajo që është më e rëndësishme, ne nuk mund të jemi përgjegjës për veprimet e ndonjë personi tjetër juridik apo fizik. Në ankesën e tij, z. Emini në mënyrë të papërcaktuar thotë se dikush, pa i përmendur emrat e personave, numrin e tyre, vendin ku votuan, as lidhjen midis personit/ave të përmendur dhe subjektit tonë politik. Shtrohet pyetja se si e di z. Emini se ata persona janë votues ose anëtarë të Listës Serbe. Në qendrën zgjedhore të përmendur, edhe z. Emini fitoi 230 vota. Gjithashtu, përveç deklaratës së tij, nuk ka asnjë provë që ngjarja e përmendur ka ndodhur, dhe letra me diagnozën e shkruar është pa emrin dhe mbiemrin e personit për të cilin bëhet fjalë. E drejta e personave për të përdorur asistencë është e rregulluar me akte juridike. Në vetë vendvotimin, vendimin për të lejuar votimin me ndihmën e një asistenti e marrin anëtarët e komisioneve zgjedhore, dhe në këtë kuptim Lista Serbe nuk mund të ketë ndikuar në faktin nëse do të lejohej apo jo votimi me asistencë, dhe për këtë arsye as nuk mund të mbartë përgjegjësi për këtë ngjarje të supozuar. Z. Emini në ankesën e tij ZL.Anr. 205/2025 kundër subjektit tonë politik ka theksuar gjithashtu se ka pasur vonesë në procesin e numërimit të votave në vendvotimin 3701/02 në komunën e Klllokotit, dhe për këtë e ka akuzuar subjektin tonë politik. Kujtojmë se procesin e numërimit të votave kryejnë anëtarët e komisioneve zgjedhore në përputhje me rregullat. Pa dashur të hyjmë në detaje, nuk shohim asnjë bazë që për punën e komisionit zgjedhor të fajësohet subjekti ynë politik i cili ka vetëm një anëtar në komisionin zgjedhor. Sipas të dhënave tona, për këto ngjarje të supozuara nuk është paraqitur asnjë ankesë në librin e procesit të votimit. Duke pasur parasysh faktet e përmendura që kemi cituar në përgjigjen tonë ndaj ankesës së pabazuar të z. Emini, kërkojmë nga PZAP që të njëjtën të refuzoj si të pabazuar.

Në përgjigjen në ankesë subjekti politik Srpska Narodna Sloga (SNS) të datës 14.10.2025, ka deklaruar se Srpska Narodna Sloga, si subjekt politik, pohon se ne nuk kemi përdorur dëshmitë mjekësore të përmendura dhe as nuk kemi marrë pjesë në lëshimin e dëshmimeve të tilla mjekësore; nëse vërtetohet e kundërta, jemi gati të përgjigjemi juridikisht. Theksojmë se SNS si subjekt politik nuk mund të mbajë përgjegjësi dhe pasoja ligjore as për dëshmitë mjekësore, pasi nuk i ka përdorur, e aq më pak për lëshimin e tyre, as për numërimin e votave në vendvotimet e Shkollës Fillore "Sveti Sava", pasi ne nuk kishim anëtarë të komisionit në ato vendvotime dhe as vëzhgues, prandaj nuk mund të kishim marrë pjesë në këto parregullsi, nëse ka pasur të tilla. Kandidati i pavarur për kryetar të komunës së Klllokotit, Arber Emini, thotë se në procesin zgjedhor është futur shteti i Serbisë, por gjithashtu ekziston dyshimi i bazuar se në procesin zgjedhor për zgjedhjet lokale në komunën e Klllokotit është futur edhe shteti i Kosovës, veçanërisht Agjencia Kosovare e Informimit, dhe ka ushtruar presion mbi votuesit që të votojnë pikërisht për kandidatin e pavarur për kryetar të komunës së Klllokotit, Arber Eminin, gjë që përben vepër penale. Gjithashtu, në ankesë thuhet se duhet të anulohen rezultatet e zgjedhjeve për vendvotimin në Shkollën Fillore "Sveti Sava" në Klllokot. Megjithatë, nga dëshmia që është bashkangjitur ankesës së kandidatit të pavarur për kryetar të komunës së Klllokotit, Arber Emini, shihet se bëhet fjalë për votuesen Gordana Jerinić nga Grnçari. Gordana Jerinić nuk voton në vendvotimin e Shkollës Fillore "Sveti Sava" në Klllokot, por voton në vendvotimin e Shkollës Fillore "Marko Rajković" në Vërboc, prandaj nuk është logjike që të anulohen rezultatet në atë vendvotim. Nga gjithçka e thënë, ne mendojmë se ankesa e kandidatit të pavarur për kryetar të komunës së Klllokotit, Arber Emini, është e pabazuar dhe duhet të hidhet poshtë si e tillë.

PZAP lidhur me rastin e ankesës i ka dërguar Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) kërkesë për përgjigje në ankesë për të dhënë sqarimet lidhur me rastin.

KQZ me datë 14.10.2025 ka dërguar përgjigje në ankesë, nëpërmjet të cilës ka deklaruar se, pas shqyrtimit të ankesës dhe pretendimeve të palës ankuese në lidhje me kërkesën e juaj, KQZ jep sqarimet/përgjigjet si më poshtë: Bazuar në nenin 89 paragrafi 5 dhe 6 të Ligjit Nr. 08/L-228 Për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, dhe Rregulloren Zgjedhore Nr. 12/2024 — Votimi, Numërimi në Vendvotim dhe Menaxhimi i Vendvotimit, sipas nenit 10, paragrafët 5, 6, 7 dhe 8, përcaktohet procedura e detajuar për realizimin e votimit me asistencë. KQZ, pas pranimit të kërkesës nga PZAP, më datën 14.10.2025 ka kontaktuar me Komisionin Komunal të Zgjedhjeve (KKZ) të Komunës së Klllokotit, nga e cila ka marrë përgjigjen se: “Unë për atë rast jam vënë në dijeni vetëm pasi erdhën nga Prokuroria. Pas bisedës dhe pasi mësova se rasti i përmendur kishte ndodhur, menjëherë dërgova anëtarë të KKZ-së për të vizituar Vendvotimin dhe për të parë në vendin ngjarjes se çfarë kishte ndodhur në të vërtetë, duke kuptuar që një rast ka ndodhur dhe anëtarët kane reaguar dhe menjëherë e kane ndërprerë votimin e mëtutjeshëm me këtë vërtetim që është lëshuar nga ana e një mjeku. Me tutje ata të gjithë kane mundur të votojnë në mënyrë të rregullt në VV 3701/2” (shih të bashkangjitur deklaratën e KKZ).

Gjithashtu, ju njoftojmë se për këtë rast KKZ-ja e Komunës së Klllokotit ka raportuar në dhomën operative të KQZ-së në ditën e zgjedhjeve, më datë 12.10.2025, duke deklaruar si në vijim: "Anëtarë i KKZ në komunën e Klllokotit ka njoftuar se një doktorësh në Klllokot është

duke lëshuar vendime për aftësi mjekësorë me qëllim që këta votues të votojnë me asistencë. Doktoresha është duke i lëshuar vendimet me datë 12.10.2025".

PZAP, pas shqyrtimit të kësaj ankese, me vendimin ZL.A.nr.205/2025 të datës 15.10.2025, ka hedhur të palejuar ankesën e kandidatit të pavarur për kryetar të Komunës së Klllokotit, Arber Emini.

Në procedurë ankimore, Gjykata Supreme e Kosovës, me aktvendimin A.A.nr.93/2025 të datës 20.10.2021, ka aprovuar ankesën e Arber Emini, kandidat i pavarur për kryetar të Komunës së Klllokotit, dhe ka anuluar vendimin e PZAP-it ZL.A.nr.205/2025 të datës 15.10.2025, dhe çështjen e ka kthyer në rivendosje në PZAP.

Me rastin e rivendosjes sipas ankesës së lartë përmendur të ankuesit Arber Emini, duke vepruar në tërësi sipas vërejtjeve të dhëna nga Gjykata Supreme e Kosovës, në aktvendimin A.A.nr.93/2025 i datës 20.10.2025, dhe me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, në këtë procedurë të rigjykimit, PZAP-i mbledhi, analizoi dhe vlerësoi provat si: dokumentin mjekësor të lëshuar nga Republika e Serbisë të votueses Gordana Jeriniq, listat e votuesve me asistencë, emailin nga Arber Emini, drejtuar Prokurorise, e datës 20.10.2025 "Kallëzim Penal" dhe provat e bashkangjitura, librat e votimit të komunës së Klllokotit të KQZ-së.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa - PZAP, pas shqyrtimit të ankesës dhe shkresave të lëndës, pretendimeve ankimore, përgjigjeve në ankesë, gjeti se:

- Ankesa është e pabazuar.

Paneli pas shikimit të shkresave të lëndës dhe përgjigjeve në ankesë, vlerësoi se pretendimet e kandidatit të pavarur për kryetar të Komunës së Klllokotit, Arber Emini janë të paqëndrueshme dhe si të tilla i refuzoj për faktin se nga veprimet e përshkruara në ankesë nuk është arritur që të vërtetohen se ka pasur parregullsi në qendra të votimit të cekura në ankesë, nga subjektet politike Srpska Lista dhe subjektit politik Srpska Narodna Sloga (SNS), ashtu siç pretendohet në ankesë. Paneli vlerëson se nga provat në ankesë dhe ato të bashkangjitura shtesë nga ankuesi nuk përkojnë me gjendjen faktike e as me shkresat e tjera të lëndës. Përkatësisht, PZAP lidhur me këtë rast ka kërkuar nga KQZ që të dërgoj librat e votimit të komunës së Klllokotit për ditën e zgjedhjeve lokale, të datës 12 Tetor 2025. Nga Librat e Votimit të Komunës së Klllokotit, në vendvotimet me numër: 3701/01, 3701/02, 3703/01, 3704/02 dhe 3705, Paneli konstaton se në këto libra të votimit nuk është paraqitur, respektivisht nuk është evidentuar ndonjë parregullsi lidhur me pretendimet e ankuesit gjatë procesit të votimit. Në librat e votimit të lartcekur të Komunës së Klllokotit janë të evidentuar anëtarët e këshillit të vendvotimit, vëzhguesit, shënimet mbi procedurën e votimit dhe procesin e numërimit gjatë ditës së zgjedhjeve si dhe lista e votuesve me asistencë. Nga këto të dhëna konstatohet se komisioneret dhe vëzhguesit, deklaratat e të cilëve ankuesi i ka bashkangjitur si prova, në librat e votimit, përkatësisht tek shënimet mbi procedurën e votimit të njëjtat të dhëna nuk përkojnë me deklaratat e pretenduar. Nga kjo rrjedhë se në ditën e votimit me datë 12.10.2025 nga komisioneret dhe vëzhguesit në asnjërin libër të votimit nuk

kanë evidentuar parregullsi si: lëshimi i vërtetimeve mjekësorë të falsifikuara më logon e Republikës së Serbisë, organizimi të votimit në grupe të organizuara dhe nën udhëheqjen e përfaqësuesve të Listës Serbe, apo votimi të paligjshëm me asistencë, ndërsa për votuesen Gordana Jerinić nuk ishte në liste e votuesve që voton në vendvotimin e Shkollës Fillore "Sveti Sava" në Kllokot, porsipas të dhënave e njëjta vendvotimin e kishte në Shkollën Fillore "Marko Rajković" në Vërboc. Paneli konstaton se nga shënimet që kemi në dispozicion konstatohet se në disa raste të parregullsive të cilat janë evidentuar, nuk përbëjnë ndonjë shkelje serioze ligjore të dispozitave të LZP-së. Rrjedhimisht, parashtruesi i ankesës në mbështetje të pretendimeve të tij, nuk ka ofruar dëshmi të qarta dhe bindëse, ashtu siç parashihet në nenin 117 paragrafi 3 të Ligjin Nr.08/L-228 Për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, barra e të provuarit bie mbi ankuesin, në të cilin nen përcaktohet se *"Vendosja për ankesat nga PZAP-ja mbështetet në dëshmi të qarta dhe bindëse"*, andaj Paneli në bazë të provave dhe dëshmive nuk mundi të konstatoj se ka pasur manipulime në qendrat e votimit të Komunës së Kllokotit me datë 12.10.2025.

Paneli vlerëson se pretendimet e ankuesi të natyrës penale nuk bien në kompetencë të PZAP, por janë në kompetencë të Prokurorisë kompetente. Ndërsa pretendimet e ankuesit për një proces jo të rregullt zgjedhor nga provat e ofruara nuk ka bazë të artikulueshme për të vërtetuar se ditën e votimit është ushtruar ndonjë ankesë apo se është paraqitur ndonjë parregullsi në ndonjë vendvotim. Paneli në bazë të të gjeturave se me 12.10.2025 as në polici nuk është paraqitur ndonjë ankesë apo kallëzim penal lidhur me votuesit me asistencë dhe dokumentacionet mjekësore të lëshuara nga shtetit i Serbisë. Andaj pretendimet e ankuesit nuk japin bazë e mjaftueshme dhe me peshë në rezultat për të urdhëruar përsëritjen e votimit në vendvotimin e pretenduar. Kështu që bazuar në nenin 117 paragrafi 3 dhe nenin 118, të LZP-së, konstatohet se nuk janë ofruar dëshmi të qarta dhe bindëse se ka pas parregullsi të asaj natyre për të ndikuar në vendimmarrje respektivisht në rezultatin preliminar. Për tu dërguar në rivotim një apo më shumë qendra të votimit vërtetë duhet që gjatë procesit paraprak të votimit të jenë bërë shkelje zgjedhore të natyrës shumë serioze, si rezultat i të cilave procesi i votimit të jetë minuar dhe që zgjedhjet të dalin me pa integritet.


Nisur nga arsyet e theksuara më lartë, e në kuptim të nenit 117 par. 3, 118 par. 1 të LZP-së, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

ZL.Anr.205-2/2025, datë 24.10.2025



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 paragrafi 4 të Ligjit Nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i marrjes-pranimit të këtij vendimi.



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

A.A.nr.99/2025

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Lumni Sallauka, kryetar, Nenad Laziq dhe Faton Ademi, anëtarë, lidhur me ankesën e kandidatit të pavarur për Kryetar të Komunës së Klllokotit Arbër Emini, për shkak të parregullsive në ditën e zgjedhjeve, në ditën e votimit për Zgjedhjet Lokale të mbajtura me datë 12.10.2025, duke vendosur lidhur me ankesën e paraqitur kundër vendimit të Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), ZL.A.nr.205-2/2025, të datës 24.10.2025, në seancën e mbajtur më datë, 28.10.2025, merr këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet e pabazuar ankesa e kandidatit të pavarur për Kryetar të Komunës së Klllokotit Arbër Emini, e paraqitur kundër vendimit të Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa, ZL.A.nr.205-2/2025, të datës 24.10.2025.

A r s y e t i m

Me vendimin e Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa, ZL.A.nr.205-2/2025, të datës 24.10.2025, është vendosur: "REFUZOHET E PABAZUAR ankesa ZL.Anr.205/2025, të datës 13.10.2025, e paraqitur nga kandidatit i pavarur për kryetar të Komunës së Klllokotit, Arber Emini, e paraqitur kundër subjektit politik Srpska Lista dhe subjektit politik Srpska Narodna Sloga (SNS), për shkak të parregullsive për ditën e zgjedhjeve, në ditën e votimit për Zgjedhjet Lokale, të mbajtura më datë 12 Tetor 2025.

Kundër vendimit të lartpërmendur, kandidati i pavarur për Kryetar të Komunës së Klllokotit Arbër Emini, në afat të lejuar ligjor ka paraqitur ankesë në Gjykatën Supreme, me të cilën i konteston rezultatet e përgjithshme të zgjedhjeve, gjegjësisht pretendon se i njëjti është dëmtuar për një numër të caktuar votash si rezultat i parregullsive me të cilat është cenuar e drejta e votës, respektivisht ka pasur manipulim të drejtpërdrejtë të votës, cenim të integritetit të kutisë së votimit dhe shkelje të detyrave zyrtare nga anëtarët e KKZ-së, si dhe shkelje tjera në qendra të vendvotimit në Komunën e Klllokotit si përdorimi i fletëvotimeve me simbole dhe shenja të veçanta, manipulim me librin e votuesve dhe fshehja e gjurmëve nga KKZ, falsifikim të të dhënave zyrtare nga KKZ dhe ndërhyrje direkte në procesin zgjedhor, si dhe audio-përgjim i montuar me përmbajtje të rreme dhe manipuluese i cili përveçse ka dëmtuar integritetin e tij personal është përdorur edhe për të dezinformuar votuesit, me propozim që Gjykata Supreme



të aprovoj ankesën si të bazuar, të shfuqizoj vendimin e PZAP, ZL.A.nr.205-2/2025, të datës 24.10.2025, dhe të urdhërohet rivotimi për Komunën e Klllokotit, për shkak të shkeljeve të shumta ligjore dhe procedurale gjatë ditës së votimit, moszbatim të vendimit të Gjykatës Supreme Nr.A.A.nr.93/2025 dhe ndërhyrjes së strukturave ilegale serbe në procesin zgjedhor në Kosovë.

PZAP në përgjigje në ankesën e paraqitur të kandidatit të pavarur për Kryetar të Komunës së Klllokotit Arbër Emini, kundër vendimit të tij të lartpërmendur, i kontestoi në tërësi thëniet ankimore dhe propozoi që ankesa e kandidatit të pavarur për Kryetar të Komunës së Klllokotit Arbër Emini, të refuzohet si e pabazuar, ndërsa të vërtetohet vendimi ZL.A.nr.205-2/2025, i datës 24.10.2025.

Gjykata Supreme e Kosovës e vlerësoi ligjshmërinë e vendimit të kontestuar, në kuptim të pretendimeve ankimore, përgjigjes në ankesë, dhe pas shqyrtimit edhe të shkresave të lëndës, gjeti se:

Ankesa është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se PZAP-i me datë 13.10.2025, ka pranuar ankesën e kandidatit të pavarur për kryetar të Komunës së Klllokotit, Arbër Emini, me të cilën pretendon se me datë 12.10.2025 në Klllokot në Zgjedhjet Lokale në Klllokot, Serbia ka ndërhyrë në sistemin Zgjedhor në Komunën e Klllokotit, duke fabrikuar dëshmi mjekësore serbe të strukturave paralele për tu shfrytëzuar votuesit me asistencë të përdorin këtë vërtetim mjekësor. Pastaj është theksuar se votuesit shqiptar nuk kanë mundur të realizojnë këtë të drejtë, sepse nuk kanë pasur vërtetime mjekësore valide të Republikës së Kosovës, por Lista Serbe dhe SNS kanë organizuar këtë metodë kundër Rendit Kushtetuese të Republikës së Kosovës me qëllim që të ndërhyj dhe të ndikojnë në rezultatin e zgjedhjeve në Klllokot, me këto dokumente jo valide të cilat në asnjë moment nuk ishin të njoftuar komisionerët dhe vëzhguesit e asnjë subjekti politik se nuk duhet ti lejohet votimi me këto dokumente të Republikës së Serbisë të lëshuara në Kosovë. Ka pretenduar se të gjitha votat me asistencë kanë përdorur dëshmi mjekësore vetëm nga institucionet shëndetësore jo valide në Kosovë dhe në disa raste nga vërtetime të falsifikuara edhe nga ndonjë institucion shëndetësor nga sistemi i RKSK. Tutje ka shtuar se, në shkollën "Sveti Sava" në Klllokot kjo metodë ka ndikuar në rezultatin zgjedhor dhe sipas informacioneve që janë ardhur nga vëzhguesit në këtë shkollë në vendvotimin me numër: 3701-SH.F.M.U Sveti Sava në Klllokot. Vendvotimet: 3701/02 janë shkelur të drejtat themelore të njeriut dhe është shkelur procedura për numërimin e fletëvotimeve të votimit. Në këto dy vendvotime janë konstatuar nga ana e vëzhguesve të mi se nuk ka filluar procesi i numërimit në kohën e duhur, por në fillim janë hapur dy kutitë dhe pastaj kanë filluar numërimin e votave vetëm për Kuvend Komunal dhe me vonë për kryetar të komunës së Klllokotit. Dyshimet tona janë esenciale dhe ndërhyjnë në rezultatin e zgjedhjeve, sepse edhe votimi me asistencë me këtë metodë ka ndikuar në këtë vendvotim dhe në të gjitha vendvotimet tjera kanë pasur ndikim dhe efekt që ndikojnë direkt në jetën e çdo qytetari në Klllokot, andaj ka kërkuar nga PZAP të merr vendim mbi rinumërimin e të gjitha vendvotimet në Komunën e Klllokotit dhe nëse konstatohen këto veprime të Serbisë apo Listës Serbe dhe SNS në Klllokot, kërkoj nga ana juaj që të anulohen vendvotimet me asistencë me dokumente mjekësore të Serbisë si jo valide në RKS dhe të përsëritet votimi në Komunën e Klllokotit për kryetar komune



në të gjitha ku konstatohet këto veprime të Serbisë në zgjedhjet në Kllokot, vendvotimet në Kllokot që kërkojmë të përsëritet votimi janë vendvotimi: 3701/02. Parashtruesi i ankesës lidhur me pretendimet e tij ka bashkangjitur si provë dëshmi të kryerjes së veprimit, përkatësisht dokumentin mjekësor të lëshuar nga Republika e Serbisë.

Në përgjigjen në ankesë subjekti politik Lista Serbe, me datë 14.10.2025, ka deklaruar se kjo ankesë është paradoksale, e pabazuar dhe absolutisht e paarsyeshme nga ana juridike. Para së gjithash, si subjekt legal politik në Kosovë, ne nuk kemi kompetenca mbi institucionet shëndetësore, qofshin ato që funksionojnë në sistemin serb apo kosovar. Duke u nisur nga ky fakt, nuk shohim të kuptimtë që ankesa të referohet subjektit tonë politik. Po ashtu, ne as nuk e dimë dhe as nuk mund ta dimë se nga erdhi kjo dëshmi, si dhe pse u lëshua, dhe ajo që është më e rëndësishme, ne nuk mund të jemi përgjegjës për veprimet e ndonjë personi tjetër juridik apo fizik. Në ankesën e tij, z. Emini në mënyrë të papërcaktuar thotë se dikush, pa i përmendur emrat e personave, numrin e tyre, vendin ku votuan, as lidhjen midis personit/ave të përmendur dhe subjektit tonë politik. Shtrohet pyetja se si e di z. Emini se ata persona janë votues ose anëtarë të Listës Serbe. Në qendrën zgjedhore të përmendur, edhe z. Emini fitoi 230 vota. Gjithashtu, përveç deklaratës së tij, nuk ka asnjë provë që ngjarja e përmendur ka ndodhur, dhe letra me diagnozën e shkruar është pa emrin dhe mbiemrin e personit për të cilin bëhet fjalë. E drejta e personave për të përdorur asistencë është e rregulluar me akte juridike. Në vetë vendvotimin, vendimin për të lejuar votimin me ndihmën e një asistenti e marrin anëtarët e komisioneve zgjedhore, dhe në këtë kuptim Lista Serbe nuk mund të ketë ndikuar në faktin nëse do të lejohej apo jo votimi me asistencë, dhe për këtë arsye as nuk mund të mbartë përgjegjësi për këtë ngjarje të supozuar. Z. Emini në ankesën e tij ZL.Anr. 205/2025 kundër subjektit tonë politik ka theksuar gjithashtu se ka pasur vonesë në procesin e numërimit të votave në vendvotimin 3701/02 në komunën e Kllokotit, dhe për këtë e ka akuzuar subjektin tonë politik. Kujtojmë se procesin e numërimit të votave e kryejnë anëtarët e komisioneve zgjedhore në përputhje me rregullat. Pa dashur të hyjmë në detaje, nuk shohim asnjë bazë që për punën e komisionit zgjedhor të fajësohet subjekti ynë politik i cili ka vetëm një anëtar në komisionin zgjedhor. Sipas të dhënave tona, për këto ngjarje të supozuara nuk është paraqitur asnjë ankesë në librin e procesit të votimit. Duke pasur parasysh faktet e përmendura që kemi cituar në përgjigjen tonë ndaj ankesës së pabazuar të z. Emini, kërkojmë nga PZAP që të njëjtën të refuzoj si të pabazuar.

Subjekti tjetër politik Srpska Narodna Sloga (SNS), në përgjigjen në ankesë të datës 14.10.2025, ka deklaruar se si subjekt politik, pohon se në nuk kemi përdorur dëshmitë mjekësore të përmendura dhe as nuk kemi marrë pjesë në lëshimin e dëshmimeve të tilla mjekësore; nëse vërtetohet e kundërta, jemi gati të përgjigjemi juridikisht. Theksojmë se SNS si subjekt politik nuk mund të mbajë përgjegjësi dhe pasoja ligjore as për dëshmitë mjekësore, pasi nuk i ka përdorur, e aq më pak për lëshimin e tyre, as për numërimin e votave në vendvotimet e Shkollës Filllore "Sveti Sava", pasi ne nuk kishim anëtarë të komisionit në ato vendvotime dhe as vëzhgues, prandaj nuk mund të kishim marrë pjesë në këto parregullsi, nëse ka pasur të tilla. Kandidati i pavarur për kryetar të komunës së Kllokotit, Arbër Emini, thotë se në procesin zgjedhor është futur shteti i Serbisë, por gjithashtu ekziston dyshimi i bazuar se në procesin zgjedhor për zgjedhjet lokale në komunën e Kllokotit është futur edhe shteti i Kosovës, veçanërisht Agjencia Kosovare e Informimit, dhe ka ushtruar presion mbi votuesit



që të votojnë pikërisht për kandidatin e pavarur për kryetar të komunës së Klllokotit, Arbër Eminin, gjë që përbën vepër penale. Gjithashtu, në ankesë thuhet se duhet të anulohen rezultatet e zgjedhjeve për vendvotimin në Shkollën Fillore "Sveti Sava" në Klllokot. Megjithatë, nga dëshmia që është bashkangjitur ankesës së kandidatit të pavarur për kryetar të komunës së Klllokotit, Arbër Emmini, shihet se bëhet fjalë për votuesen Gordana Jerinić nga Grnçari. Gordana Jerinić nuk voton në vendvotimin e Shkollës Fillore "Sveti Sava" në Klllokot, por voton në vendvotimin e Shkollës Fillore "Marko Rajković" në Vërboc, prandaj nuk është logjike që të anulohen rezultatet në atë vendvotim. Nga gjithçka e thënë, ne mendojmë se ankesa e kandidatit të pavarur për kryetar të komunës së Klllokotit, Arbër Emmini, është e pabazuar dhe duhet të hidhet poshtë si e tillë.

Në përgjigjen e KQZ-së, theksohet se KQZ me datë 14.10.2025, ka dërguar përgjigje në ankesë, nëpërmjet të cilës ka deklaruar se, pas shqyrtimit të ankesës dhe pretendimeve të palës ankuese në lidhje me kërkesën e juaj, KQZ jep sqarimet/përgjigjet si më poshtë: Bazuar në nenin 89 paragrafi 5 dhe 6 të Ligjit Nr. 08/L-228 Për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, dhe Rregulloren Zgjedhore Nr. 12/2024- - Votimi, Numërimi në Vendvotim dhe Menaxhimi i Vendvotimit, sipas nenit 10, paragrafët 5, 6, 7 dhe 8, përcaktohet procedura e detajuar për realizimin e votimit me asistencë. KQZ, pas pranimit të kërkesës nga PZAP, më datën 14.10.2025 ka kontaktuar me Komisionin Komunal të Zgjedhjeve (KKZ) të Komunës së Klllokotit, nga e cila ka marrë përgjigjen se: "Unë për atë rast jam vënë në dijeni vetëm pasi erdhën nga Prokuroria. Pas bisedës dhe pasi mësova se rasti i përmendur kishte ndodhur, menjëherë dërgova anëtarë të KKZ-së për të vizituar Vendvotimin dhe për të parë në vendin ngjarjes se çfarë kishte ndodhur në të vërtetë, duke kuptuar që një rast ka ndodhur dhe anëtarët kane reaguar dhe menjëherë e kane ndërprerë votimin e mëtutjeshëm me këtë vërtetim që është lëshuar nga ana e një mjeku. Me tutje ata të gjithë kane mundur të votojnë në mënyrë të rregullt në VV 3701/2" (shih të bashkangjitur deklaratën e KKZ). Gjithashtu, ju njoftojmë se për këtë rast KKZ-ja e Komunës së Klllokotit ka raportuar në dhomën operative të KQZ-së në ditën e zgjedhjeve, më datë 12.10.2025, duke deklaruar si në vijim: "Anëtar i KKZ në komunën e Klllokotit ka njoftuar se një mjek në Klllokot është duke lëshuar vendime për aftësi mjekësore me qëllim që këta votues të votojnë me asistencë. Doktoresha është duke i lëshuar vendimet me datë 12.10.2025".

PZAP, pas shqyrtimit të kësaj ankese, me vendimin ZL.A.nr.205/2025, të datës 15.10.2025, ka hedhur të palejuar ankesën e kandidatit të pavarur për kryetar të Komunës së Klllokotit, Arbër Emmini. Në procedurë ankimore, Gjykata Supreme e Kosovës, me aktvendimin A.A.nr.93/2025, të datës 20.10.2025, ka aprovuar ankesën e Arber Emmini, kandidat i pavarur për kryetar të Komunës së Klllokotit, dhe ka anuluar vendimin e PZAP-it ZL.A.nr.205/2025, të datës 15.10.2025, dhe çështjen e ka kthyer në rivendosje në PZAP.


Me rastin e rivendosjes sipas ankesës së lartë përmendur të ankuesit Arbër Emmini, duke vepruar në tërësi sipas vërejtjeve të dhëna nga Gjykata Supreme e Kosovës, në aktvendimin A.A.nr.93/2025, të datës 20.10.2025, dhe me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, në këtë procedurë të rigjykit, PZAP-i mblodhi, analizoi dhe vlerësoi provat si: dokumentin mjekësor të lëshuar nga Republika e Serbisë të votueses Gordana Jerinić, listat e votuesve me asistencë, emailin nga Arbër Emmini, drejtuar Prokurorisë, e datës 20.10.2025



"Kallëzim Penal" dhe provat e bashkangjitura, librat e votimit të komunës së Klllokotit të KQZ-së, ku pas shqyrtimit të ankesës dhe shkresave të lëndës, pretendimeve ankimore, përgjigjeve në ankesë, gjeti se ankesa është e pabazuar.

PZAP pas shikimit të shkresave të lëndës dhe përgjigjeve në ankesë, vlerësoj se pretendimet e kandidatit të pavarur për kryetar të Komunës së Klllokot, Arbër Emini janë të paqëndrueshme dhe si të tilla i refuzoj për faktin se nga veprimet e përshkruara në ankesë nuk është arritur që të vërtetohen se ka pasur parregullsi në qendra të votimit të cekura në ankesë, nga subjektet politike Lista Serbe dhe subjektit politik Srpska Narodna Sloga (SNS), ashtu siç pretendohet në ankesë. Paneli vlerëson se nga provat në ankesë dhe ato të bashkangjitura shtesë nga ankuesi nuk përkojnë me gjendjen faktike e as me shkresat e tjera të lëndës. Përkatësisht, PZAP lidhur me këtë rast ka kërkuar nga KQZ që të dërgoj librat e votimit të komunës së Klllokotit për ditën e zgjedhjeve lokale, të datës 12 Tetor 2025. Nga Librat e Votimit të Komunës së Klllokotit, në vendvotimet me numër: 3701/01, 3701/02, 3703/01, 3704/02 dhe 3705, Paneli konstaton se në këto libra të votimit nuk është paraqitur, respektivisht nuk është evidentuar ndonjë parregullsi lidhur me pretendimet e ankuesit gjatë procesit të votimit. Në librat e votimit të lartcekur të Komunës së Klllokotit janë të evidentuar anëtarët e këshillit të vendvotimit, vëzhguesit, shënimet mbi procedurën e votimit dhe procesin e numërimit gjatë ditës së zgjedhjeve si dhe lista e votuesve me asistencë. Nga këto të dhëna konstatohet se komisionerët dhe vëzhguesit, deklaratat e të cilëve ankuesi i ka bashkangjitur si prova, në librat e votimit, përkatësisht tek shënimet mbi procedurën e votimit të njëjta të dhëna nuk përkojnë me deklaratat e pretenduar. Nga kjo rrjedhë se në ditën e votimit me datë 12.10.2025 nga komisionerët dhe vëzhguesit në asnjërin libër të votimit nuk kanë evidentuar parregullsi si: lëshimi i vërtetimeve mjekësorë të falsifikuara më logon e Republikës së Serbisë, organizimi të votimit në grupe të organizuara dhe nën udhëheqjen e përfaqësuesve të Listës Serbe, apo votimi të paligjshëm me asistencë, ndërsa për votuesen Gordana Jerinić nuk ishte në liste e votuesve që voton në vendvotimin e Shkollës fillore "Sveti Sava" në Klllokot, por sipas të dhënave e njëjta vendvotimin e kishte në Shkollën Fillore "Marko Rajković" në Vërboc. Paneli konstaton se nga shënimet që kemi në dispozicion konstatohet se në disa raste të parregullsive të cilat janë evidentuar, nuk përbëjnë ndonjë shkelje serioze ligjore të dispozitave të LZP-së. Rrjedhimisht, parashtruesi i ankesës në mbështetje të pretendimeve të tij, nuk ka ofruar dëshmi të qarta dhe bindëse, ashtu siç parashihet në nenin 117 paragrafi 3 të Ligjin Nr.08/L-228 Për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, barra e të provuarit bie mbi ankuesin, në të cilin nen përcaktohet se "Vendosja për ankesat nga PZAP-ja mbështetet në dëshmi të qarta dhe bindëse", andaj Paneli në bazë të provave dhe dëshmive nuk mundi të konstatoj se ka pasur manipulime në qendrat e votimit të Komunës së Klllokotit me datë 12.10.2025.

Po ashtu Paneli ka vlerësuar se pretendimet e ankuesit të natyrës penale nuk bien në kompetencë të PZAP, por janë në kompetencë të Prokurorisë kompetente. Ndërsa pretendimet e ankuesit për një proces jo të rregullt zgjedhor nga provat e ofruara nuk ka bazë të artikulueshme për të vërtetuar se ditën e votimit është ushtruar ndonjë ankesë apo se është paraqitur ndonjë parregullsi në ndonjë vendvotim. Paneli në bazë të të gjeturave se me 12.10.2025 as në polici nuk është paraqitur ndonjë ankesë apo kallëzim penal lidhur me votuesit me asistencë dhe dokumentacionet mjekësore të lëshuara nga shteti i Serbisë. Andaj pretendimet e ankuesit nuk japin bazë e njafueshme dhe me peshë në rezultat për të urdhëruar



përsëritjen e votimit në vendvotimin e pretenduar. Kështu që bazuar në nenin 117 paragrafi 3 dhe nenin 118, të LZP-së, konstatohet se nuk janë ofruar dëshmi të qarta dhe bindëse se ka pas parregullsi të asaj natyre për të ndikuar në vendimmarrje respektivisht në rezultatin preliminar. Për tu dërguar në rivotim një apo më shumë qendra të votimit vërtetë duhet që gjatë procesit paraprak të votimit të jenë bërë shkelje zgjedhore të natyrës shumë serioze, si rezultat i të cilave procesi i votimit të jetë minuar dhe që zgjedhjet të dalin me pa integritet.

Gjykata Supreme e Kosovës, duke u nisur nga gjendja e tillë faktike dhe ligjore e çështjes, e pranon në tërësi si të drejtë dhe të bazuar qëndrimin juridik të PZAP-it, si në vendimin e tij, lidhur me refuzimin e ankesës së kandidatit të pavarur për kryetar të Komunës së Klllokot, Arbër Emmini, për shkak të parregullsive në ditën e zgjedhjeve, në ditën e votimit për Zgjedhjet Lokale të mbajtura me datë 12.10.2025, respektivisht parregullsive të pretenduara nga ankuesi lidhur me procesin zgjedhor. Vendimi i PZAP është i drejtë, i kuptueshëm dhe përmban arsye të mjaftueshme për faktet vendimtare, nga vërtetohet se edhe e drejta materiale është zbatuar drejtë në kuptim të dispozitave ligjore të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës. Nga kjo rezulton se shkeljet e pretenduara për parregullsi të procesit të votimit në qendrat e votimit në Komunën e Klllokotit vlerësohen të pabazuara.

Si rrjedhojë, objekt shqyrtimi dhe vlerësimi në Gjykatën Supreme ishin pretendimet ankimore të kandidatit të pavarur për kryetar të Komunës së Klllokot, Arbër Emmini, për shkak të parregullsive në ditën e zgjedhjeve, në ditën e votimit për Zgjedhjet Lokale të mbajtura me datë 12.10.2025, respektivisht parregullsive të pretenduara nga ankuesi lidhur me procesin zgjedhor, mirëpo këto pretendime dhe të tjerat në këtë drejtim nga kolegji i kësaj gjykate refuzohen si të pabazuara. Kjo për faktin se PZAP, me rastin e refuzimit të ankesës së ankuesit, si në vendimin e atakuar, me të drejtë ka vlerësuar se nga provat në ankesë dhe ato të bashkangjitura shtesë nga ankuesi nuk kanë përkuar me gjendjen faktike e as me shkresat e tjera të lëndës. Në lidhje me këtë, nga shkresat e lëndës rezulton se PZAP lidhur me këtë rast ka kërkuar nga KQZ që të dërgoj librat e votimit të komunës së Klllokotit për ditën e zgjedhjeve lokale, të datës 12 Tetor 2025, ndërsa pas verifikimeve të bëra në Librat e Votimit të Komunës së Klllokotit, në vendvotimet me numër: 3701/01, 3701/02, 3703/01, 3704/02 dhe 3705, është konstatuar se në këto libra të votimit nuk është paraqitur, respektivisht nuk është evidentuar ndonjë parregullsi lidhur me pretendimet e ankuesit gjatë procesit të votimit. Ndërsa, në librat e votimit të Komunës së Klllokotit, sipas PZAP-it janë të evidentuar anëtarët e këshillit të vendvotimit, vëzhguesit, shënimet mbi procedurën e votimit dhe procesin e numërimit gjatë ditës së zgjedhjeve, si dhe lista e votuesve me asistencë. Nga këto të dhëna, PZAP ka konstatuar se komisioneret dhe vëzhguesit, deklaratat e të cilëve ankuesi i ka bashkangjitur si prova, në librat e votimit, përkatësisht tek shënimet mbi procedurën e votimit, të njëjtat të dhëna nuk përkojnë me deklaratat e pretenduara. Më tutje, PZAP pas verifikimeve të kryera ka konstatuar se në ditën e votimit me datë 12.10.2025, nga komisioneret dhe vëzhguesit në asnjërin libër të votimit nuk janë evidentuar parregullsi si: lëshimi i vërtetimeve mjekësore të falsifikuara në logon e Republikës së Serbisë, organizimi të votimit në grupe të organizuara dhe nën udhëheqjen e përfaqësuesve të Listës Serbe, apo votimi të paligjshëm me asistencë, ndërsa për votuesen Gordana Jerinić nuk ishte në listën e votuesve që voton në vendvotimin e Shkollës Fillore "Sveti Sava" në Klllokot, por sipas të dhënave e njëjta vendvotimin e kishte në Shkollën



Filllore "Marko Rajković" në Vërboc. Si rrjedhojë e të cekurave më lartë, edhe për kolegjin e Gjykatës Supreme është i drejtë dhe i ligjshëm konstatimi i PZAP-së se parashtruesi i ankesës në mbështetje të pretendimeve të tij, nuk ka ofruar dëshmi të qarta dhe bindëse, ashtu siç parashihet në nenin 117 paragrafi 3 të Ligjit Nr.08/L-228 Për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, për çka edhe me të drejtë një ankesë e tillë është refuzuar si e pabazuar.

Në anën tjetër, kolegji i Gjykatës Supreme, ka vlerësuar edhe pretendimet ankimore të ankuesit që kanë të bëjnë me elemente të kryerjes së veprave penale që janë kryer ditën e zgjedhjeve në Komunën e Klllokotit, të përshkruara në ankesën e ankuesit dhe që sipas tij cenojnë procesin zgjedhor në Kosovë. Mirëpo, për të njëjtat veç ka dhënë sqarimet e duhura PZAP në vendimin e atakuar, ku me të drejtë është theksuar se hetimi dhe vërtetimi i këtyre pretendimeve të natyrës penale nuk bien në kompetencë të PZAP, por në kompetencë të Prokurorisë kompetente (nga shkresat e lëndës rezulton se ankuesi ka deponuar kallëzim penal në Prokurori për pretendimet e tij për dyshimin e kryerjes së veprave penale të përshkruara në ankesë, gjatë ditës së zgjedhjeve në Komunën e Klllokotit). Ndërsa pretendimet tjera të ankuesit për një proces jo të rregullt zgjedhor, nga provat e ofruara rezulton se me të drejtë PZAP-i ka konstatuar se nuk ka bazë të mjaftueshme për të vërtetuar se ditën e votimit është ushtruar ndonjë ankesë apo se është paraqitur ndonjë parregullsi në ndonjë vendvotim. Si rrjedhojë, sipas vlerësimit të kolegjit të kësaj gjykate, pretendimet ankimore të ankuesit nuk kanë pasur bazë të mjaftueshme dhe me peshë në rezultat për të urdhëruar eventualisht përsëritjen e votimit në vendvotimin e pretenduar. Në lidhje me këtë, sipas vlerësimit të kolegjit të Gjykatës Supreme me drejtë ka konstatuar PZAP-i në vendimin e atakuar se për tu dërguar në rivotim një apo më shumë qendra të votimit vërtetë duhet që gjatë procesit paraprak të votimit të jenë bërë shkelje zgjedhore të natyrës shumë serioze, si rezultat i të cilave procesi i votimit të jetë minuar dhe që zgjedhjet të dalin me pa integritet. Mirëpo, nga provat e ofruara nga ana e parashtruesit të ankesës nuk janë vërtetuar këto pretendime, për çka edhe vendimi i PZAP-it për refuzimin e ankesës së parashtruar nga ankuesi, vlerësohet i drejtë dhe i ligjshëm.

Në lidhje me këtë, me nenin 117 të Ligjit Nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, janë përcaktuar [Procedurat e PZAP-së], ku me paragrafin 3 të këtij neni përcaktohet se: *"3. Vendosja për ankesat nga PZAP-ja mbështetet në dëshmi të qarta dhe bindëse, ndërsa me paragrafin 4 të këtij neni përcaktohet se: PZAP-ja mund të urdhërojë rinumërimin e fletëvotimeve në një vendvotim apo qendër votimi si dhe shqyrtimin e materialit votues si pjesë të hetimeve për ankesën e parashtruar"*. Ndërsa, sipas nenit 118 [Vendimet], të këtij ligji përcaktohet se: *"1. PZAP-ja pranon ankesat e bazuara në fakte dhe refuzon ankesat të cilat nuk përmbushin kriteret e miratuara paraprakisht"*. Sipas nenit 13 paragrafit 2 [Vendimmarrja e PZAP-it], të Rregullores nr.01/2025, për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosjes së Ankesave, përcaktohet se: *"PZAP-i aprovon ankesat e bazuar në fakte dhe refuzon ankesat në mungesë të provave"*. Mbi këtë bazë kjo gjykatë i ka vlerësuar të pabazuara edhe pretendimet lidhur me atë se vendimi i PZAP është jo bindës dhe kontradiktorë, kjo për faktin se duke u bazuar në gjendjen faktike të vërtetuar nga PZAP, dhe dispozitave të lartcekura, vlerëson se e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë, nga çka rezulton se vendimi i atakuar është i drejtë dhe i ligjshëm, dhe në përputhje me dispozitat e Ligjit mbi Zgjedhjet e Përgjithshme të Republikës së Kosovës dhe me Rregulloren nr.01/2025, pasi që në mungesë të provave të qëndrueshme me të drejtë është refuzuar ankesa e ankuesit.



Nisur nga gjendja faktike e vërtetuar, kjo Gjykatë konstatoi se në këtë çështje juridike, gjendja faktike është vërtetuar drejt dhe nuk është shkelur ligji në dëm të parashtruesit të ankesës, prandaj, pretendimet ankimore janë refuzuar si të pabazuara. Kjo për faktin se si të tilla nuk dëshmuar se përmbushin shkaqet për të cilat mund të paraqitet ankesa që të prezantohen fakte të reja nga pala e interesuar dhe, nuk u gjetën shkelje procedurale e as ndonjë gabim faktik i cili ndikon në të drejtat e palës apo ligjshmërinë e procedurës.

Nga theksimet si më lartë dhe në bazë të nenit 118 paragraf 4, të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS

A.A.nr.99/2025, datë 28.10.2025

Kryetari i kolegjit,
Lumni Sallauka



Republika e Kosovës
Republika Kosovo
SAKTËSINË E KOPJËS E VËRTETON
TAČNOST OTPRAVKA POTVRDJUJE

autorizuar
Cvjašeni radnik



GJYKATA SUPREME E KOSOVËS

FLETËDËRGESË PËR DORËZIM PERSONAL

DOSTAVNICA ZA LJICNO DOSTAVLANJE

1. Pasi marrësi, i cili me tentimin e parë të dorëzimit nuk u gjet në vendin e ku është dëshitë të bëhet dorëzimi i sa pas lënjes së larmërimit me shkrim që për shkak të dorëzimit të gjendet në kohën e caktuar në banesën apo në vendin e punës së tij, dorëzimi është bërë: anëtarit madhor të familjes së marrësit - kujdestarit të ndërtësës, fqut, personit që punon po n'atë vend me marrësin.

1. Posto primilac, koji pri prvom pokušaju dostave nije zatecen na mestu gde se dostavljanje ina izvršiti ni posle ostavljenog pismenog obavestjenja da radi dostavljanja bude u određeno vreme u svom stanu radnom mestu, dostava je izvršena: odraslom članu domaćin. Primaoca nastojniku zgrade susedu licu zaposlenom na istom radnom mestu primaocen

2. Pasi marrësi ose anëtar i familjes së tij e refuzon marrjen e shkresës, shkresa u la në banesë në vendin e punës së marrësit (duke e ngjitur në derën e banesës ose të lokalit ku gjendet në punë marrësi).

2. Posto primilac odnosno član njenog domaćinstva odbio prijem, pismo je dostavljeno u stanu - radnom mestu primaoca (priblieno na vratima stana odnosno prostorije gde primilac zaposlen)

Më _____ 201 _____ në ora _____
dana _____ u _____ cas.
Shkaku i refuzimit të marrjes _____
Razlog odbijanja prijmea _____

Nënshkrimi i dorëzuesit - potpis dostavljaca

(Të panevojshmeve bjeri vizë - nepotrečne precrtati)

Sheji i shkresës
Oznaka spisa:

AA-99/2025

Emri i shkresës që dorëzohet:
Naslov pisma koja se dostavlja:

AKTGURUKANI

28.10.2025

Numri i shtojcave: _____
broj priloga _____

Vërtetoi se mora shkresën e lartpërmendur
më (me fjalë) _____

Povrdujemo prijem gorenavegenog pisma
(i slovima) 30.10.2025

V.5H 14.44

(Nënshkrimi i marrësit ose i atij që
e ka marrë aktin në vend të tij
Potpis primaoca ili lica koje je
pismo primilo u zameni)

Nënshkrimi i dorëzuesit - potpis dostavljaca

Në rast se marrësi është analfabet ose nuk është në gjendje të nënshkruajë
dorëzues, duke shkruar shkronja pse marrësi nuk e ka vënë nënshkrimin e vet.
Ako je primilac neplemen ili nije u stanju da se potpiše, potpisuje ga dostavljač.
napomenom zasto primilac nije stavio svoj potpis.

Fm 12/88